

LIBRI I RUTËS

Ruta nuk e lë vjehrrën e saj në baltë

1¹⁻²Në kohën kur izraelitët ishin ende nën sundimin e gjyqtarëve, në tokën (e premtuar) shpërtheu një zi buke. Prandaj, Elimelehu prej klanit të Efratit, e la vendlindjen e tij, Bet-Lehehin në Judë, dhe shkoi me gruan e tij, Noeminë, dhe të bijtë, Mahlonin dhe Kiljonin, në vendin e Moavit. Gjatë kohës që banuan atje, ³Elimelehu vdiq, dhe Noemia mbeti vejushë, me të dy bijtë e saj. ⁴Bijtë e saj u martuan me dy gra moavase, Orpën dhe Rutën. Dhjetë vjet më vonë, vdiqën edhe Mahloni dhe Kiljoni, ⁵dhe nëna e tyre, Noemia, tani mbeti vetëm dhe pa mbrojtje.

⁶⁻⁷Kur mori vesh që Zoti e kishte ndihmuar popullin e tij dhe që në Judë kishte përsëri për të ngrënë, ajo vendosi të largohej nga vendi i Moavit dhe të kthehej në Judë. E shoqëruan të dyja të rejat.

⁸Rrugës ajo u tha të dyjave: «Kthehuni! Kthehuni te nënat tuaja. Zoti t'ju shpërbleftë për të mirat që u keni bërë atyre që janë tani të vdekur si dhe mua! ⁹Ju martoftë dhe ju bëftë që të gjeni lumturi në shtëpitë e tyre!»

Noemia i puthi të dyjat, që të ndahej prej tyre. Por ato qanin ¹⁰dhe i thanë: «Ne nuk do të të lëmë. Do të vijmë me ty, te populli yt.»

¹¹Noemia kundërshtoi: «Kthehuni, bijat e mia! Përse doni të vini me mua? Unë nuk kam më djem të tjerë, të cilët mund të bëhen burrat tuaj. ¹²Shkoni, kthehuni, bijat e mia! Unë jam shumë e moshuar për t'u martuar përsëri. Edhe po të ishte e mundur kjo dhe të martohesha sot, e pastaj të lindja djem – ¹³a do t'i pritni ju ata gjersa të rriten? Doni të mbeten të vetmuara për një kohë kaq të gjatë dhe të hiqni dorë nga burrat? Jo, bijat e mia!»

¹⁴Ruta dhe Orpa qanin edhe më shumë. Orpa e puthi vjehrrën e saj dhe u nda nga ajo; por Ruta nuk pranoi të ndahej. ¹⁵Noemia i tha asaj: «Shihe kumatën tënde; ajo u kthye te populli i saj dhe te perëndia i saj. Ndiqe edhe ti shembullin e saj!»

¹⁶Por Ruta iu përgjigj: «Mos më shtrëngo të të lël! Dua të qëndroj me ty. Kudo që të shkosh, do të vij edhe unë; kudo që të vendosesh, do të vendosem edhe unë me ty. Populli yt do të jetë populli im, dhe Perëndia jote do të jetë Perëndia ime. ¹⁷Kudo që të vdesesh dhe të varrosesh ti, atje do të vdes dhe do të varrosem edhe unë. Në qoftë se më ndan nga ti diçka tjetër përveç vdekjes, le të më gjejë zemërimi i Zotit!»

¹⁸Kur Noemia e pa, që Ruta ishte shumë e vendosur, hoqi dorë për ta bindur që të kthehej në shtëpi.

¹⁹Kështu, të dyja shkuan së bashku në Bet-Lehem. Kur mbërritën atje, menjëherë lajmi u përhap në mbarë qytetin dhe gratë thirrën: «Vallë kjo është Noemia?»

²⁰«Mos më quani më Noemi, – u tha, – më quani Mara (Hidhërim), sepse Perëndia, i Gjithëpushtetshmi, më ka përgatitur një fat të hidhur. ²¹Që këtu u nisa me burrin tim dhe me dy bij. Tani Zoti bën që të kthehem në vendin tim e varfër dhe pa mbrojtës. Përse më quani ende Noemi? Zoti i gjithëfuqishëm u drejtua kundër meje dhe më rrëzoi në mjerim.»

²²Kështu, Noemia u kthye në Bet-Lehem me të renë e saj atëherë kur atje kishin filluar të korrat e elbit.

Ruta gjen një mbrojtës

2Noemia kishte një të afërm me emrin Boaz. Ai i takonte klanit të Elimelehut dhe ishte njeri i aftë dhe me pasuri. ²Një ditë Ruta i tha vjehrrës së saj: «Dua të dal për t'i mbledhur kallinj të që kanë lënë korrësit. Do të gjej dikë që do të më japë lejën për këtë.»

«Mirë, – tha Noemia, – shko lirisht!» ³Ruta shkoi në arë dhe mblodhi kallinj pas korrësve. Ndodhi që ara i takonte tokës së Boazit.

⁴Pak më vonë vetë Boazi u nis nga qyteti dhe u doli korrësve përpara.

«Zoti me ju!» – i përshëndeti, dhe ata iu përgjigjën: «Zoti të bekoftë!»

⁵Boazi e pyeti njeriun që ishte mbikëqyrës mbi korrësit: «Nga është ajo vajza atje?»

⁶Ai iu përgjigj: «Ajo është një moavase, ka ardhur me Noeminë. ⁷Ajo na u lut që ta lejonim të mblidhte atë që lënë korrësit midis duajve. Ajo ka që nga agimi në këmbë, dhe tani është ulur në hije dhe po bën pushim për herë të parë.»

⁸Atëherë Boazi iu drejtua Rutës i tha: «Dëgjoje këshillën time! Mos shko në asnjë arë tjetër për të mbledhur kallinj. Rri këtu dhe qëndro pranë shërbëtorëve të mia. ⁹Mblidh gjithnjë atje ku po korret dhe shko pas lidhësve të duajve. U kam dhënë urdhër shërbëtorëve të mi që mos të të mërzhitin. Kur të kesh etje, shko te shtambat dhe pi nga uji që kanë sjellë me vete shërbëtorët.»

¹⁰Ruta ra përmbys dhe e pyeti: «Pse je kaq mirëdashës ndaj meje? Sidoqoftë, unë jam e huaj.»

¹¹Boazi iu përgjigj: «Më kanë treguar gjithçka që ke bërë për vjehrrën tënde, që nga vdekja e burrit tënd. Ti i ke lënë prindërit dhe vendin tënd dhe ke ardhur te një popull, që më parë nuk e njihje. ¹²Zoti, Perëndia e Izraelit, tek i cili ke kërkuar strehim, të shpërbleftë me pasuri për gjithçka që ke bërë.»

¹³«Mirësia jote më ndihmoftë edhe në të ardhmen! – iu përgjigj Ruta. – Ti më ke ngushëlluar dhe ke folur me mua me shumë mirësi, megjithëse jam më e ulët se shërbëtorët e tua.»

¹⁴Në orën e ngrënies, Boazi i tha Rutës: «Eja te ne dhe merr bukë! Ti mund ta lyesh atë në musht.»

Kështu, Ruta u ul pranë korrësve, dhe Boazi i dha kokrra gruri të pjekura me aq bollëk, sa që asaj i tepruan shumë. ¹⁵Kur ajo u ngrit, për t'i mbledhur përsëri kallinj, Boazi u dha urdhër shërbëtorëve të tij: «Lëreni të mbledhë midis duajve të ngritur dhe mos e pengoni. ¹⁶Lini me qëllim kallinj që të bien nga duajt, që të mund t'i mbledhë ajo, dhe mos i thoni asnjë fjalë të ashpër!»

Vjehrra e Rutës e njej fatin hyjnor

¹⁷Kështu, Ruta mblodhi kallinj, deri në mbrëmje dhe pastaj i shiu ato. Ajo kishte mbledhur rreth dhjetë kilogramë. ¹⁸Ajo e mbajti trastën deri në qytet dhe ia çoi vjehrrës elbin e mbledhur. Asaj ia dha edhe kokrrat e grurit të pjekur, që i tepruan nga dreka. ¹⁹Noemia e pyeti: «Ku i ke mbledhur kallinj të sot? Në arën e kujt ishe? Zoti e bekoftë njeriun që të ka dhënë leje.»

Ruta i tregoi se ai njeri ishte Boazi. ²⁰Atëherë Noemia i tha: «Tani e kuptoj se Zoti nuk na ka lënë në baltë, as të gjallët e as të vdekurit tanë. Zoti e bekoftë atë burrë! Ti duhet ta dish, – vazhdoi ajo, – se Boazi është i afërmi ynë. Ai i takon rrethit të atyre që, sipas Ligjit, detyrohen të na ndihmojnë.»

²¹Ruta më tej i tregoi: «Ai më tha se duhet të lidhem me njerëzit e tij, derisa t'i kenë mbledhur të gjitha të korrat e tyre.» ²²«Mirë, ashtu – tha Noemia. – Shko vetëm me shërbëtorët e tij. Në ndonjë arë tjetër ka mundësi që njerëzit të të mërzhitin.»

²³Gjatë gjithë kohës së të korrave të elbit dhe të grurit, Ruta ishte e lidhur me shërbëtorët e Boazit. Por, në mbrëmje kthehej çdo herë te vjehrra e saj.

Ruta guxon të lutet për diçka

3 Një ditë, Noemia i tha Rutës: «Dua që ti të gjesh përsëri një burrë dhe një atdhe. ²E di se Boazi, me shërbëtorët e të cilit ishe e lidhur, është i afërmi ynë. Sonte në mbrëmje, ai do të punojë me lopatë në lëmë për të ndarë bykun nga elbi. ³Lahu dhe lyeju, vishu me rrobat më të mira dhe shko në lëmë. Kujdes që mos të të vërë re, para se të mbarojë darkën. ⁴Shiko ku shtrihet dhe, kur ta ketë zënë gjumi, futu nën batanijen e tij te këmbët. Ai do të të tregojë se ç'duhet të bësh!»

⁵⁻⁶«Do të bëj gjithçka sipas këshillës sate» – iu përgjigj Ruta dhe shkoi në lëmë. ⁷Pasi hëngri dhe piu Boazi, ra të flinte me qejf dhe i kënaqur në një anë të grumbullit të drithit. Ruta u afrua tinëz dhe iu fut nën batanije, në fund të këmbëve. ⁸Në mesnatë, Boazi u çua nga gjumi i trembur dhe u përku nga këmbët. Atje ishte shtrirë një grua. ⁹«Kush je ti?» – pyeti. «Jam Ruta – iu përgjigj ajo. – Më fal, kërkoj mbrojtje tek ti. Ti u takon atyre që, sipas Ligjit, janë të detyruar të më ndihmojnë.»

¹⁰Boazi iu përgjigj: «Zoti të bekoftë! Kjo gjë që po bën tani, tregon, më shumë se gjithçka tjetër, që ke bërë gjer këtu, se ti ke mbetur besnike ndaj vjehrrës sate. Ti kishe mundësi të martoheshe me një burrë më të ri dhe me siguri do të kishe gjetur një burrë të pasur. ¹¹Mos ki merak! Do të bëj gjithçka që kërkon prej meje. Kushdo në qytet e di se ti je grua e aftë. ¹²Dhe është e vërtetë që unë jam i detyruar të të ndihmoj. Por është edhe një njeri tjetër që është më i afërt se unë. ¹³Kaloje natën këtu! Nesër në mëngjes do t'ia lë atij të zgjedhë, nëse do ta përmbushë detyrimin ose jo. Përndryshe, do ta përmbush unë. Këtë ta premtoj, betohem për Zotin që vepron. Qëndro këtu deri në mëngjes!»

¹⁴Ruta u shtri përsëri; por u ngrit para se të zbardhte agimi, kur njerëzit mund ta njihnin. Sepse vetë Boazi tha: «Është më mirë që askush të mos e marrë vesh që një grua ishte në lëmë.» ¹⁵Para se të nisej Ruta, Boazi i tha: «Hiqe mantelin dhe shtrije në tokë!» Ai derdhi në të rreth njëzet kilogramë elb dhe ia ngriti ngarkesën në sup. Pastaj ajo u kthye në qytet.

¹⁶Kur Ruta u kthye në shtëpi, vjehrra e saj e pyeti, se si vajti puna. Ruta i tregoi se Boazi i ishte përgjigjur me dashamirësi. ¹⁷«Më dha edhe tërë këtë elb – shtoi ajo. – Nuk donte që të kthehesha duarzbrazët te vjehrra ime.» ¹⁸Noemia iu përgjigj: «Tani ti mund të presësh e qetë se si do të përfundojë puna. Boazi nuk do të jetë i qetë derisa ta zgjidhë këtë çështje.»

Ruta merr një burrë bujar

4 Ndërkohë, Boazi kishte shkuar në sheshin e mbledhjes, pranë portës së qytetit, dhe atje ishte ulur. Kur kaloi njeriu që ishte më i detyruar se ai për ta ndihmuar Rutën, i thirri e i tha: «Afruhu dhe ulu!»

²Pastaj Boazi thirri dhjetë burra nga pleqtë e qytetit dhe, pasi u ulën edhe ata, ³i tha njërit: «Ti e di se Noemia është kthyer nga vendi i Moavit. Ajo do të shesë ngastrën që i takonte të afërmit tonë, Elimelehut. Për këtë doja të të bëja një propozim: Bleje ti tokën, në prani të pleqve dhe të burrave të tjerë të mbledhur këtu. Thuaj nëse do ta bësh apo jo! Unë duhet ta di, sepse ti je i pari, i cili është i detyruar për këtë; pas teje e kam unë radhën.»

Tjetri iu përgjigj: «Do ta bëj.»

⁵Boazi vazhdoi: «Në qoftë se ia blen Noemisë arën, njëkohësisht ti merr përsipër detyrën që të kujdesesh për gruan moavase, Rutën, dhe në vend të burrit të vdekur, të bësh me të fëmijë, të cilit do t'i takojë ngastra e blerë si tokë e trashëgueshme.» ⁶«Në qoftë se është kështu, heq dorë – tha tjetri. – Ndryshe do të dëmtoj trashëgimin tim. E dorëzoj të drejtën. Nuk mund ta mbroj.»

⁷⁻⁸Pastaj hoqi këpucën dhe ia dorëzoi Boazit. Dikur në Izrael, në rastin e përfundimit të ndonjë marrëveshjeje tregtare, me këtë shenjë miratohej ndërrimi i së drejtës së pronarit mbi diçka. ⁹Boazi iu

drejtua burrave të pranishëm e u tha: «Ju sot jeni dëshmitarë që unë ia kam blerë Noemisë gjithçka që i takonte Elimelehut dhe bijve të tij, Kiljonit dhe Mahlonit. ¹⁰Gjithashtu kam marrë për grua vejushën e Mahlonit, gruan moavase, Rutën, dhe kam marrë përsipër detyrimin që të bëj një bir, në vend të Mahlonit, të cilit do t'i takojë trashëgimi i tij. Emri i Mahlonit nuk duhet të harrohet në klanin e tij dhe familja e tij duhet të qëndrojë në këtë qytet dhe në Izrael. Ju e dëgjuat deklaratën time dhe për këtë jeni dëshmitarë.» ¹¹Pleqtë dhe të gjithë burrat e tjerë që ishin në shesh pranë portës, thanë: «Ne jemi dëshmitarë për këtë! Zoti e bekoftë gruan tënde, dhe ata që do të hyjnë në shtëpinë tënde. Të dhëntë aq fëmijë sa Rahelës dhe Leas, prej të cilave rrjedh mbarë Izraeli. Fitofsh ndikim në klanin tënd dhe u bëfsh i famshëm ndër banorët e Bet-Lehemit. ¹²Me anë të pasardhësve që do të t'i japë Zoti nëpërmjet gruas sate, familja jote u bëftë e rëndësishme si familja e Percit, birit të Tamarës dhe Judës.

Ruta bëhet stërgjyshja e mbretit David

¹³Kështu, Boazi e mori Rutën për grua. Zoti bëri që Ruta të mbetej shtatzënë dhe të lindë një djalë.

¹⁴Atëherë gratë i thanë Noemisë: «Lavdi i qoftë Zotit! Ai të ka dhuruar një mbrojtës. Nipi yt le të bëhet i famshëm në Izrael! ¹⁵Të sjell të jetë të re e u bëftë shkop i pleqërisë sate. Sepse ai është biri i së resë sate, që mori me kaq besnikëri anën tënde. Me të vërtetë, ti ke tek ajo më shumë se shtatë bij!»¹⁶Noemia e mori foshnjën në prehrin e saj dhe e rriti si fëmijën e vet. ¹⁷Gratë e fqinjëve e quanin «birin e Noemisë» dhe i vunë emrin Oved. Ovedit i lindi Jishai, biri i të cilit ishte mbreti David.

¹⁸⁻²²Gjenealogjia nga Perci deri te Davidi kalon nëpër: Hecronin, Ramin, Aminadavin, Nahshonin, Salmonin, Boazin, Ovedin dhe Jishain, biri i të cilit ishte mbreti David.